



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 6309/1 Prot.

Lushnje më, 31/07/2023

PROJEKT-VENDIM

NR. 65 DATË 31/07/2023

“PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË PASURIVE NR. 475, ZK. 1033, FSHATI ARDENICË DHE NR. 146/9, ZK. 2207, FSHATI KOLONJË, E LLOJIT PYLL, NJËSIA ADMINISTRATIVE KOLONJË.”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ___/___/2023 në mbështetje të: nenit 9 pika 1.2/a/c dhe neni 54, gërma “e”, pika 1 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM-në nr. 684, datë 02.09.2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive,” të ndryshuar, nenit 801 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Udhëzimit Nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, me kërkesë të Zyrës së Menaxhimit të Aseteve:

PROPOZOJMË:


- I.** Të miratoj dhënien me qira të pasurive nr. 475, ZK. 1033, me sipërfaqe 8300 m², fshati Ardenicë dhe nr. 146/9, ZK. 2207, me sipërfaqe 3700 m², fshati Kolonjë, e llojit pyll, Njësia Administrative Kolonjë, për një periudhe 10 (dhjetë) vjeçare.
- II.** Për lidhjen e kontratave të zbatohen procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 1, datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës dhe Zyra e Aseteve.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

PËR ZYREN E MENAXHIMIT TË ASETVEVE

Liri Murati
Sara Manoku



DR. DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida



KRYETARI I BASHKISË

ERISELDA SEFA

